



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04
Prokurori kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 21 shtator 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për Kalimin e Dosjes së Çështjes Gjyqësore Trupit Gjykses I

Trupit Gjykses I

Gjykatës Roland Dekers
Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Gjykatës Zhilber Biti
Gjykatës Vladimir Mikula (gjykatës rezervë)

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtjes së të Akuzuarit

Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtjes së Viktimave

Sajmon Loz

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të rregullës 98(1) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 19 qershor 2020, pas vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake (“Vendimi i Konfirmimit”),² Prokurori i Specializuar dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar kundër Pjetër Shalës (“z. Shala” ose “i akuzuari”).³
2. Më 16 mars 2021, pas fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, z. Shala u arrestua në Mbretërinë e Belgjikës (“Belgjikë”).⁴ Më 15 prill 2021,

¹ KSC-BC-2020-04, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-04, F00007, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik u nxorën më 6 maj 2021, F00007/CONF/RED dhe F00007/RED.

³ KSC-BC-2020-04, F00010, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar*, 19 qershor 2020, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale. Versioni konfidencial me më pak redaktime dhe versioni publik i redaktuar më tej i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzuan më 31 mars 2021, F00016/A01, konfidencial, F00016/A02, publik. Versioni konfidencial me edhe më pak redaktime i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 25 maj 2021, F00038/A01. Pas vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për mocionin e Mbrojtjes që kundërshton formën e Aktakuzës së Konfirmuar, u dorëzua një aktakuzë e korrigjuar më 1 nëntor 2021, F00098/A01, konfidenciale, dhe 16 nëntor 2021, F00107/A01, publike.

⁴ KSC-BC-2020-04, F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimit dhe Urdhrit të Transferimit*, 12 qershor 2020, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u nxor më 6 maj 2021, F00008/RED; F00008/A01, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Fletarrestim për z. Pjetër Shala*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik u nxor më 15 prill 2021, F00008/A01/RED. *Shih* gjithashtu KSC-BC-2020-04, F00013, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4)*, 16 mars 2021, publik.

me përfundimin e procedurave gjyqësore në Belgjikë, z. Shala u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("DHS") në Hagë, Holandë.⁵

3. Më 20 korrik 2022, Gjykatësi i Procedurës Parapake informoi palët dhe Mbrojtjen e Viktimave se kalimi i dosjes së çështjes gjyqësore Trupit Gjykues parashihet të kryhet më 21 shtator 2022.⁶

4. Më 15 shtator 2022, Gjykatësi i Procedurës Parapake njoftoi Kryetaren e Dhomave të Specializuara ("Kryetarja") se dosja e plotë e çështjes gjyqësore do të jetë gati për t'i kaluar Trupit Gjykues të mërkurën, 21 shtator 2022.⁷

5. Më 15 shtator 2022, Kryetarja ia caktoi çështjen Trupit Gjykues I, të përbërë nga gjykatësit Roland Dekers, Mapi Feld-Folia, Zhilber Biti, dhe Vladimir Mikula (gjykatës rezervë).⁸

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Në bazë të rregullës 98(1) të Rregullores, pas marrjes së dosjeve paraprahe përkatëse të ZPS-së dhe të Mbrojtjes, listave të dëshmitarëve dhe listave të provave materiale, sikurse përcaktohet në rregullën 95(4) dhe (5) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprahe i kalon Trupit Gjykues dosjen e plotë të çështjes gjyqësore, e cila përmban:

⁵ KSC-BC-2020-04, F00019, Administratorja, *Njoftim për Pranimin e Pjetër Shalës në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe për Caktimin me Kusht të Mbrojtësit*, 15 prill 2021, konfidencial, para. 2, me Shtojcat 1-2, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u nxor më 26 prill 2021, F00019/RED. F00013, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4)*, 16 mars 2021, publik.

⁶ KSC-BC-2020-04, F00234, Gjykatësi i Procedurës Paraprahe, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar sipas Rregullës 102(2) dhe Kërkesat në lidhje me Të*, 20 korrik 2022, konfidencial, para. 46(f). Versioni i redaktuar publik u nxor më 8 gusht 2022, F00234/RED.

⁷ KSC-BC-2020-04, F00275, Gjykatësi i Procedurës Paraprahe, *Njoftim në Bazë të Rregullës 98(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave*, 15 shtator 2022, publik, para. 4.

⁸ KSC-BC-2020-04, F00276, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Trupit Gjykues I*, 15 shtator, publik.

- (a) Aktakuzën e Konfirmuar;
- (b) të gjitha parashtrimet dhe materialet e dorëzuara nëpërmjet sistemit elektronik të administrimit gjyqësor;
- (c) çfarëdo provash të administruara që nuk përmenden në paragrafin (1)(b);
- (d) çfarëdo letërkëmbimi tjetër në lidhje me çështjen që nuk është dorëzuar në Njësinë e Administrimit të Gjykatës;
- (e) një dokument dorëzues që përfshin:
 - (i). argumentet e palëve dhe nëse është e zbatueshme, të mbrojtësit të viktimave, në lidhje me faktet dhe ligjin përkatës;
 - (ii). pikat për të cilat palët pajtohen;
 - (iii). provat e paraqitura nga secila palë;
 - (iv). sugjerime në lidhje me numrin dhe rëndësinë e dëshmitarëve që do të thirren;
 - (v). pikat e kundërshtuara faktike dhe ligjore;
 - (vi). ecurinë e nxjerrjes së materialeve;
 - (vii). të gjitha mbledhjet me palët; dhe
 - (viii). çfarëdo çështje tjetër të pazgjidhur
- (f) kërkesa dhe vendime në lidhje me nxjerrjen e materialit; dhe
- (g) çfarëdo materiali tjetër që ka lidhje me çështjen.

7. Në bazë të rregullës 98(2) të Rregullores, kalimi i dosjes së çështjes gjyqësore kryhet në mënyrë elektronike.

III. DISKUTIM

8. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se janë kryer të gjithë hapat proceduralë të nevojshëm për ta konsideruar dosjen e çështjes gjyqësore KSC-BC-2020-04 të plotë dhe, për rrjedhojë, gati për t'ia kaluar Trupit Gjyqësor I, në përputhje me rregullën 98 të Rregullores.

9. Në veçanti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka përgatitur një dokument dorëzues që përfshin informacionin e përcaktuar në rregullën 98(1)(e) të Rregullores, për Trupin Gjyqësor, palët dhe mbrojtësin e viktimave. Gjykatësi i Procedurës Paraprake specifikon se, për shkak të informacionit jopublik që përmban dokumenti dorëzues, ai nuk mund të bëhet publik në këtë fazë. Dokumenti dorëzues i bashkëlidhet këtij vendimi.

IV. VENDIM

10. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia **KALON** dosjen e çështjes gjyqësore KSC-BC-2020-04 Trupit Gjyqësor I, së bashku me dokumentin dorëzues bashkëlidhur këtij vendimi.

_____/nënshkrimi/_____

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E mërkurë, 21 shtator 2022

Në Hagë, Holandë.